



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 683/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, të paraqitura për shkak të mospërputhjeve të votave të vlefshme dhe të pavlefshme në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve (QNR) në Fushë Kosovë, në seancën e panelit të mbajtur me 28.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

Hidhen poshtë si të palejuara ankesat me numër të lendes A 683/2010 datë 22.12.2010, A 685/2010 datë 22.12.2010 dhe A 691/2010 date 24.12.2010, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar dy ankesa me datë 22.12.2010 dhe një ankese me date 24.12.2010, nga subjekti politik LVV.

Në ankesën A nr. 683/2010, parashtruesi i ankesës pretendon se me datë 21.12.2010 në QNR, në ora 16:00 në Fushë Kosovë, ka pasur mospërputhje të votave të vlefshme, të pavlefshme, të paplotësuara dhe librit të nënshkrimeve, në këto kuti votimi: 04080/02R të regjistruara 8 vota më shumë, 0901X/01R të regjistruara 16 vota më shumë, 2001A/01R të regjistruara 22 vota më shumë, 2008A/05R të regjistruara 9 vota më pak, 2015A/03R të regjistruara 15 vota më pak, 2201E/04R të regjistruara 22 vota më shumë. Po ashtu në ankesë theksohet se QNR-ja nuk i ka mbajtur shënimet për auditim ose hetim, që sipas subjektit politik LVV, është në kundërshtim me nenin 5.1 (a), (c), (d) të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2008.

Në ankesën A nr. 685/2010, parashtruesi i ankesës pretendon se rreth orës 00:30 pas mesnatës me datë 22.12.2010, në QNR në Fushë Kosovë, në tavolinën nr. 30, konkretisht në kutinë e votimit 1102X08R ka pasur mospërputhje ndërmjet votave të vlefshme dhe të pavlefshme, votave të paplotësuara dhe nënshkrimeve, ku sipas LVV-se kanë munguar 58 vota, edhe përkundër kësaj kutia nuk është dërguar për hetim në

karantinë. Parashtruesi i ankesës më këtë konsideron se është bërë shkelje e neni 5 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.06/2008.

Ne ankesën A nr. 691/2010, subjekti politik LVV, pretendon se me date 23.12.2010, ne orën 17:00 ne QNR, kutia me nr. 1839/01R nuk ka qene e etiketuar si dhe janë vërejtur parregullsi te tjera si mospërputhje midis numrit te nënshkrimeve dhe fletëvotimeve te vlefshme, te paplotësuara, te pavlefshme dhe nënshkrimeve te dublikuara. Sipas parashtruesit te ankesës, ky fakt përben shkelje te nenit 5.1 pika (a) dhe (c) e Rregullës Zgjedhore Nr.06/2008.

Neni 106 paragrafi 1 dhe 2 i LZP-së, specifikon se:

106.1 “KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare te zgjedhjeve, pas përfundimit te te gjitha procedurave ne vendvotime dhe ne qendrat e numërimit si dhe kur te gjitha ankesat qe u përkasin votimit dhe numërimit te vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve te PZAP-it lidhur me to te jete vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës”.

106.2 “Para certifikimit te rezultatit te zgjedhjeve, KQZ-ja mund te urdhërojë rinumërimin e votave ne cilindo vendvotim, qendër te numërimit ose edhe përsëritjen e votimit ne një qendër votimi apo ne një komune”.

Neni 4.2 dhe 6.3 dhe i Rregullave dhe Procedurave te PZAP parasheh si vijon:

4.2 PZAP-i mund t'i hidh poshtë (si të palejuara, të parregullta apo të pasafatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore. Në rast se ankesa nuk i plotëson këto kriteret, PZAP-i mund t'i japë palës ankuese një periudhë të arsyeshme kohore, siç është paraparë në njoftim, për t'i plotësuar ato kriteret.

6.3 “Me qellim te lehtësimin te shqyrtimit te ankesave, kryesuesi i panelit mund te vendose ta bej bashkimin e ankesave qe përmbajnë ne vete çështje te ngjashme, paneli vendimmarrës i trajton ato si kur te ishin një ankese”.

PZAP gjeti se:

- **ankesat janë te palejuara**

Bazuar ne vendimin e PZAP-it me numër te lendes A490 te dt. 16.12.2010, KQZ-ja ne përputhje me nenin 106. 2 te LPZ, ne dt. 16.12.2010 urdhërojë përsëritjen e votimit ne komunat e Gllogovc, Deçanit dhe Skenderaj. Gjithashtu KQZ-ja ka urdhëruar përsëritjen e votimit ne QV 1304E ne komunën e Lipjanit dhe QV 3008A ne komunën e Malishevës. Si rrjedhim i përsëritjes se votimit ne këto komuna dhe vendvotime, rezultatet preliminare te zgjedhjeve te parakohshme për Asamblenë e Kosovës mund të ndryshojnë. Duke vlerësuar se do te këtë përsëritje te numërimit te votave dhe se procesi zgjedhor nuk do te konsiderohet i përfunduar deri ne momentin qe rivotimi te jete kryer, si dhe ne kuptim te nenit 106.1 te LPZ-se certifikimi i rezultateve preliminare është i pa përfunduar, PZAP gjykon se ankesat e subjektit politik LVV, nuk janë te lejuara. Prandaj ne këtë faze te procedurës, interesi ligjor i palës mund te

ndryshoj ne varësi te procesit te rinumërimit ne QNR si pasoje e vendimit te KQZ-se. Për këto arsye si dhe bazuar ne dispozitat ligjore te cituara me larte dhe ne kuptim te nenit 115.1 te LPZ-se, PZAP vendosi si ne dispozitiv te këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 683/2010 më datën 28.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

